



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:131070

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737188

C.nr. 907/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike të paditëses J.B. e lindur Q. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. E. Gj. nga Prizreni, kundër të paditurve I.Q., Q.Q., S.Q., L.Q. dhe B.Q., që të gjithë nga fsh. Zhur, Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 03.04.2024, në prezencë të autorizuarës së paditëses dhe të autorizuarit të paditurës, pas pranimit të fjalëve përfundimtare me datë 18.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses **J.B. e lindur Q.** nga Prizreni, ashtu që **VËRTETOHET** se paditësja J.B. e lindur Q. është pronare me 1/5 e pjesës ideale të paluajtshmërisë të cilat janë të regjistruara si njësi kadastrale si në vijim:

- P-71813026-01168-0, në sipërfaqe prej 13084 m2, me kulturë "kullose" kl.6;
- P-71813026-01169-0, në sipërfaqe prej 864 m2, me kulture "mal" kl.6;
- P-71813026-01170-0, në sipërfaqe prej 13084 m2, me kulture "Mal" kl.6;
- P-71813026-01171-0, në sipërfaqe prej 1554 m2, me kulture "arë" kl.7,
- P-71813026-01172-0, në sipërfaqe prej 26109 m2, me kulture "kullosë" kl.6,
- P-71813026-01173-0, në sipërfaqe prej 12885m2, me kulturë " " ;
- P-71813026-01174-0, në sipërfaqe prej 2672 m2, me kulturë "livadh" kl.7;
- P-71813026-01175-0, në sipërfaqe prej 1249 m2, me kulturë "mal" kl.5;
- P-71813026-01176-0, në sipërfaqe prej 2422m2, me kulturë "kullosë" kl.5;
- P-71813026-03469-0, ne sipërfaqe prej 250 m2, me kulturë "shtëpi me oborr";
- P-71813026-03470-0, në sipërfaqe prej 205m, me kulturë "arë" kl.4;
- P-71813026-03471-0, në sipërfaqe prei 260m2, me kulturë "pemishte" kl.4;
- P-71813026-03472-0, në sipërfaqe prei 290m2, me kulturë "rrugë private";
- P-71813026-03473-0, ne sipërfaqe prej 1591m2, me kulture "kullosë" kl.3 dhe
- P-71813026-03474-0, në sipërfaqe prej 790m2, me kulture "vreshtë" kl.4, të gjitha në Zonën Kadastrale Zhur ;
- P-71813006-00654-0 në sipërfaqe prej 520 m2, me kulturë "arë" kl.1 dhe

- P-71813006-00745-1 në sipërfaqe prej 4363 m², me kulture "arë" kl.1. të dy këto ngastrat Zona Kadastrale Vlashnje , që i kanë takuar si trashëgimtarë i rendit të parë ligjor pas vdekjes së trashëgimlënës M.A.Q. ish nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit.

II. DETYROHEN të paditurit I.Q., Q.Q., S.Q., L.Q. dhe B.Q., që të gjithë nga fsh. Zhur, Komuna e Prizrenit, që paditëses t'ia lejojnë regjistrimin e të drejtave pronësore në librat kadastral, në pjesë ideale të përcaktuar sikurse në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

III. MASA E PËRKOHSHME E SIGURIMIT e caktuar nga ana e kësaj gjykate, me aktvendimin C.nr.907/2019 datë 16.09.2021, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi ose deri në marrjen e vendimit tjetër nga ana e kësaj gjykate.

IV. OBLIGOHEN të paditurit I.Q., Q.Q., S.Q., L.Q. dhe B.Q., që të gjithë nga fsh. Zhur, Komuna e Prizrenit, që paditëses J.B. e lindur Q. nga Prizreni, në mënyrë solidare t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej **405.00 € (katërqind e pesë euro)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja J.B. e lindur Q. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurve I.Q., Q.Q., S.Q., L.Q. dhe B.Q., që të gjithë nga fsh. Zhur, Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro.

Në padi paditësja ka theksuar se është e bija (trashëgimtare) e tani të ndjerit M.A.Q. ish nga fsh. Zhur, Komuna e Prizrenit, i cili ka ndërruar jetë me 13 gusht 1987 në fsh. Zhur. Të paditurit janë pasardhës të të ndjerit dhe se me datë 24.11.2016 kanë dhënë deklaratë për përpilimin e aktvdekjes për të ndjerin, me ç'rast kanë paraqitur si trashëgimtarë bijtë dhe bijat e të ndjerit, si dhe fëmijët e trashëgimtarit të vdekur A.Q. dhe atë L.dhe B.Q. e nuk e kanë deklaruar dhe nuk e kanë përfshirë në aktvdekje si trashëgimtare këtu paditësen. Të paditurit me aktvendimin e nxjerrë nga noteri B.Sh.L. me seli në Prizren, LRP.nr.4595/2016 të datës 30.11.2016 janë shpallë trashëgimtarë në tërë pasurinë e lënë në trashëgim të paditurit. Procedura e shpalljes së trashëgimtarëve ligjorë për të ndjerin M. duke e përjashtuar paditësen nga e drejta në trashëgimi është në kundërshtim me ligjin. Andaj gjykatës i ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Paditësja me parashtrësën e datës 25.06.2019, ka bërë plotësimin dhe zgjerimin e kërkesë padisë, në të cilën ka theksuar se gjatë përpilimit të padisë gabimisht nuk janë përfshirë dy prona – paluajtshmëri që janë pasuri që i ndjeri ka lënë pas vdekjes dhe atë ngastrat kadastrale P-71813006-00654-0 në sipërfaqe prej 520m² me kulturë "arë" kl.1 dhe ngastrat kadastrale P-71813006-00745-1 në sipërfaqe prej 4363 m² me kulturë "arë" e kl.1.

E autorizuar e paditëses gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se ngel në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë ndërsa në fjalën ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se mbetet pranë parashtrësës për plotësimin

dhe zgjerimin e padisë duke shtuar se nuk është kontestuese se tani i ndjeri M. (A) Q. ish nga fsh.Zhur - Komuna e Prizrenit ka ndërruar jete me 13 gusht 1987, në fsh. Zhur, i cili fakt vërtetohet nga certifikata e vdekjes dhe akti i vdekjes, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Komunën e Prizrenit nr.200-811 e datës 24.11.2016. Të paditurit duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme nuk kanë paraqitur të gjithë trashëgimtarët ligjor të rendit të parë, kështu që me dt.30.11.2016, janë paraqitur ne Zyrën e noterit B.L. ku është zhvilluar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit M.Q. ku të njëjtit kanë inicuar procedurën e trashëgimisë, kanë dhënë deklaratat e trashëgimisë e me pastaj është marre aktvendimi i trashëgimisë LRP. Nr.n.4595/2016 te dt.30.11.2016, me te cilin këtu te paditurit janë shpallur trashëgimtar në tërë pasurinë e decujusit. Padiësja është e bija e M.O. ish nga fsh.Zhur, njëherit e njëjta është trashëgimtare ligjore e rendit të parë të trashëgimisë, i cili fakt vërtetohet me certifikatën e lindjes, mirëpo te njëjtën fare nuk e kanë njoftuar te paditurit për iniciimin e procedurës së trashëgimisë. Për të vërtetuar gjendjen faktike në teren, gjeodeti i licencuar D.B. ka përpiluar ekspertizën dhe raportin e veçantë të mbështetur në foto nga terreni dhe ortofoto, skicën grafike të terrenit lidhur me paluajtshmëritë lëndore duke konstatuar kulturën, klasën, sipërfaqen e pronave dhe Zonat Kadastrale. Duke marrë parasysh faktin se padiësja si trashëgimtare ligjore e rendit të parë të trashëgimisë ka të drejtën e pa tjetërsueshme në trashëgimi të cilin ia mundëson ligji duke mos ia mohuar të drejtën trashëgimtarëve të tjerë ligjor. Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e padiësës dhe të vërtetohet se e njëjta në bazë të trashëgimisë është bashkëpronare me nga 1/5 e pjesëve ideale të paluajtshmërive të cilat i takojnë e që evidentohen si ngastrat kadastrale më afër të përshkruara në petitumin e kërkesëpadiësë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për pjesëmarrje në pesë seanca të mbajtura nga 136 euro, gjithsej shumën prej 680 euro.

Të paditurit në përgjigjen në padi kanë theksuar se padia dhe kërkesëpadia e padiësës është tërësisht e pa bazuar ngase padiësës të paditurit gjatë jetës ia kanë ndarë truallin dhe ia kanë ndërtuar shtëpinë në Prizren për banim dhe jetesë, kështu që e njëjta me atë është përmbushur në tërësi me kërkesëpadinë të cilën e ka parashtruar me padi. Andaj në tërësi e kanë kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e padiësës si ligjërish të pa bazuar në pretendimet e saja në 1/5 e pjesës ideale të paluajtshmërive nga dispozitivi i kërkesëpadiësë ngase e njëjta është përmbushur në kërkesëpadinë e saj.

I autorizuari i paditurve gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se me të gjitha provat pa mëdyshje është vërtetuar arsyeshmëria e refuzimit të kërkesëpadiësë dhe se gjykatës i mbetet që të bëjë vlerësimin e këtyre provave si dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të aplikueshme, meritorisht të vendosi dhe të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë me që e njëjta është ligjërish të pa bazuar. Ka shtuar se nuk është kontestuese fakti se i ati i palëve ndërgjyqëse ka vdekur me datë 13 gusht 1987 dhe se i njëjti pas vetes ka lënë trashëgimtarët ligjorë: djemtë I., Q., S.Q., dhe A.Q. i cili më datë 2011 ka ndërruar jetë dhe nga pasardhësit e tjerë i ka lënë: bashkëshorten L. qikën Liridonën dhe djemtë L. e B.Q., bijat S., H., K., Sh. dhe J. Pra siç vërtetohet në rastin e ndarjes së masës trashëgimore që ka lënë i ndjeri M.Q. ajo trashëgimi do tu ndahej trashëgimtarëve ligjor të rendit të parë, pra pasardhësve të ndjerit do t'u takonte secilit pjesa me nga 1/9 nga masa trashëgimore pronë personale e të ndjerit. Me aktin noterial LRP.nr.4595/2016, T.nr.Ref.1165/2016 të lëshuar nga Zyra Noteriale e noterit B.L. trashëgimtarë ligjorë janë shpallur I., Q., S.Q., nga fakti se trashëgimtarët S., H., K. dhe Sh. pjesët e tyre ligjore i kanë ceduar në llogari të vëllezërve I., Q. dhe S.Q. e njëherit trashëgimtarë të të atit të tyre janë shpallur L. dhe B.Q. që janë pasardhësit e të atit të tyre – të ndjerit A.Q. ndërsa trashëgimtarët e tjerë si L. dhe L. janë deklaruar se të drejtën ligjore që u takon e kanë ceduar të vëllezërit L. e

B.Q. Pra me asnjë bazë ligjore paditëses nuk mund ti takojë pjesa e kërkuar në 1/5, me që në aktvdekjen që është lëshuar në emër të të ndjerit janë 9 trashëgimtarë duke përfshirë edhe paditësen. Pas vdekjes së të atit i cili ka vdekur në vitin 1987, ndërsa kërkesëpadia është deponuar në gjykatë në vitin 2016, pra për plot 30 vite pas vdekjes së M.Q. që rezultoi se ka ardhur parashkrimi absolut i mundësisë për të kërkuar vërtetimin e pronësisë në këtë bazë nga fakti se dispozitat ligjore nga neni 141 të Ligjit mbi Trashëgimin të RSFJ-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur pala paditëse – ka mundur të paraqesë kërkesë në këtë bazë, por edhe me dispozitat ligjore tani të ligjit për trashëgiminë e Kosovës ligji nr.2004/26, konkretisht në nenin 136.1 është paraparë “E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjet duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit. Me nenin 138.2 të këtij ligji është paraparë “Ndaj poseduesit me keqbesim kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vitesh nga koha e parashikuar në par.1.” Andaj, bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 1,500.00 euro.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin e ekspertizës së ekspertit D.B. e datës 16.01.2023, leximin e ekstraktit të lindjes për J.B. e datës 14.03.2019 dhe aktvdekjes për M.A.Q. e datës 24.11.2016, leximin e aktit noterial LRP.nr.4595/2016 lidhur me trashëgiminë e M.A.Q. i datës 30.11.2016, leximin e certifikatës pronësore lidhur me ngastrat kadastrale kontestuese datë 18.03.2019, leximin e vendimit të MPMS i datës 17.06.2019 lidhur me njohjen e të drejtës me aftësi të përhershme për paditësen dhe leximin e njoftimit mbi pushimin e hetimeve PP.nr.1820-11/23 e datës 04.03.2024.

Nga leximi i ekspertizës së ekspertit D.B. e datës 16.01.2023, gjykata vërtetoi faktin se në terren është bërë identifikimi i të gjitha njësive kadastrale të cilat janë objekt i këtij kontesti e të cilat ngastra kadastrale janë: nr.00654-0 ZK Vlashnjë, nr.00745-1 ZK Vlashnjë, nr.03472-0 ZK Zhur, nr.03469-0 ZK Zhur, nr.03470-0 ZK Zhur, nr. 03471-0 ZK Zhur, nr.03473-0 ZK Zhur, nr.03474-0 ZK Zhur, nr.1168-0 ZK Zhur, 01169-0 ZK Zhur, 01170-0 ZK Zhur, 01171-0 ZK Zhur, 01172-0 ZK Zhur, nr.01173-0 ZK Zhur, 01174-0 ZK Zhur, 01175-0 ZK Zhur, 01176-0 ZK Zhur, të cilat evidentohet me pronarë I.Q. me 2/8 e pjesës ideale, Q.Q. me 2/8 e pjesës ideale, S.Ç. me 2/8 e pjesës ideale, L.Ç. me 1/8 e pjesës ideale dhe B.Ç. me 1/8 e pjesës ideale.

Nga leximi i ekstraktit të lindjes për J.B. e datës 14.03.2019 dhe aktvdekjes për M.A.Q. e datës 24.11.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është e lindur me datë 30.12.1974 nga i ati- trashëgimlënësi M.Q. dhe e ëma S.Q., ndërsa paditësi M.A.Q. ka vdekur me datë 13.08.1987 dhe se personat që janë thirr në trashëgim në bazë të testamentit janë: H.S.Ç. (e bija) , S.E.Q. (e bija), Sh.B.Q. (e bija), K.K.Q. (e bija), I.Q. (i biri), Q.Q. (i biri), S.Q. (i biri), L.Q. (e reja), B.Q. (nipi), L.Ç. (nipi) dhe L.G. (mbesa). Pas vetes ka lënë Zonat Kadastrale Vlashnjë 00654-0 pjesa e pronës 1/3, 00745-1 pjesa e pronës 1/3, Zona Kadastrale ZK Zhur 00168-0 pjesa e pronës 1/1, 00169-0 pjesa e pronës 1/1, 00170-0 pjesa e pronës 1/1, 00171-0 pjesa e pronës 1/1, 00172-0 pjesa e pronës 1/1, 03471-0 pjesa e pronës 1/1, 03472-0 pjesa e pronës 1/1, 03473-0 pjesa e pronës 1/1, 03474-0 pjesa e pronës 1/1, 01173-0 pjesa e pronës 1/1, 01174-0 pjesa e pronës 1/1, 01175-0 pjesa e pronës 1/1, 01176-0 pjesa e pronës 1/1, 03469-0 pjesa e pronës 1/1 dhe 03470-0 pjesa e pronës 1/1 dhe se trashëgimtarët e vdekur janë S.Q. – bashkëshortja me datë 29/10/2014 dhe A.Q. i biri i vdekur me datë 30/12/2011.

Nga leximi i aktit noterial LRP.nr.4595/2016 lidhur me trashëgiminë e M.A.Q. i datës 30.11.2016, gjykata ka vërtetuar se palët/trashëgimtarët I.Q., Q.Q., S.Ç., (bijtë e të ndjerit) e L.Ç. dhe B.Q., (nipat e të ndjerit M.Q. – djemtë e A.Q.) janë shpallur trashëgimtarë të rendit të parë të pasurisë së trashëgimlënësit M.Q. në njësitë kadastrale P-71813026-01168-0, në sipërfaqe prej 13084 m2, me kulturë "kullose" kl.6, P-71813026-01169-0, në sipërfaqe prej 13104 m2, me kulture "mal" kl.6, P-71813026-01170-0, në sipërfaqe prej 864 m2, me kulture "Mal" kl.6, P-71813026-01171-0, në sipërfaqe prej 15542 m2, me kulture "arë" kl.7, P-71813026-01172-0, në sipërfaqe prej 26109 m2, me kulture "kulosë" kl.6, P-71813026-01173-0, në sipërfaqe prej 12885m2, me kulturë", P-71813026-01174-0, në sipërfaqe prej 2672 m2, me kulturë "livadh" kl.7, P-71813026-01175-0, në sipërfaqe prej 1249 m2, me kulturë "mal" kl.5, P-71813026-01176-0, në sipërfaqe prej 2422m2, me kulturë "kulosë" kl.5, P-71813026-03469-0, ne sipërfaqe prej 250 m2, me kulturë "shtëpi me oborr", P-71813026-03470-0, në sipërfaqe prej 205m, me kulturë "arë" kl.4, P-71813026-03471-0, në sipërfaqe prej 260m2, me kulturë "pemishte" kl.4, P-71813026-03472-0, në sipërfaqe prej 290m2, me kulturë "rrugë private", P-71813026-03473-0, ne sipërfaqe prej 1591m2, me kulture "kulosë" kl.3 dhe P-71813026-03474-0, në sipërfaqe prej 790m2, me kulture "vreshtë" kl.4, që të gjitha në Zonën Kadastrale Zhur si dhe ngastrat kadastrale: P-71813006-00654-0 ne sipërfaqe prej 520 m2, me kulturë "arë" kl.1 dhe P-71813006-00745-1 në sipërfaqe prej 4363 m2, me kulture "arë" kl.1. Zona Kadastrale Vlashnje dhe atë djemtë me nga 2/8 në mënyrë të barabartë, ndërsa nipat në mënyrë të barabartë me nga 1/8 dhe në bazë të dokumentit të parashtruar, noteri ka konstatuar se trashëgimlënësi – i ndjeri ka lënë pas më të afërmit e tij të cilët thirren në trashëgimi si trashëgimtarë ligjor të rendit të parë: bijtë dhe bijat S.E. lind. Q., H.S. lind. Q., I.Q., Q.Q., K. K. lind. Q., Sh.B. lind. Q., dhe S.Q. si dhe e reja, mbesa dhe nipat e trashëgimlënësit – L.Q. lind. O., L.G. lind. Q., L.Ç. dhe B.Q. Bijtë e trashëgimlënësit I.Q., Q.Q. dhe S.Q. dhe nipat L.Ç. dhe B.Q. kanë pranuar trashëgiminë që iu takon në bazë të ligjit ndërsa trashëgimtarët e tjerë kanë hequr dorë nga trashëgimia në dobi të trashëgimtarëve të tjerë. Dhe se në këtë lëndë lidhur me trashëgiminë nuk është përfshirë e bija e trashëgimlënësit – paditësja J.B. e lind. Q.

Nga leximi i certifikatës pronësore lidhur me ngastrat kadastrale kontestuese datë 18.03.2019, gjykata vërtetoi se I.Q. pas vetes ka lënë njësitë kadastrale P-71813006-00654-0 ne sipërfaqe prej 520 m2, me kulturë "arë" kl.1, ZK Vlashnjë, -71813006-00745-1 në sipërfaqe prej 4363 m2, me kulture "arë" kl.1. Zona Kadastrale Vlashnjë, P-71813026-01168-0, në sipërfaqe prej 13084 m2, me kulturë "kullose" kl.6 ZK Zhur, P-71813026-01169-0, në sipërfaqe prej 13104 m2, me kulture "mal" kl.6 ZK Zhur, P-71813026-01170-0, në sipërfaqe prej 864 m2, me kulture "Mal" kl.6, ZK Zhur, P-71813026-01171-0, në sipërfaqe prej 15542 m2, me kulture "arë" kl.7, ZK Zhur, P-71813026-01172-0, në sipërfaqe prej 26109 m2, me kulture "kulosë" kl.6, P-71813026-01173-0, në sipërfaqe prej 12885m2, me kulturë", P-71813026-01174-0, në sipërfaqe prej 2672 m2, me kulturë "livadh" kl.7, P-71813026-01175-0, në sipërfaqe prej 1249 m2, me kulturë "mal" kl.5, P-71813026-01176-0, në sipërfaqe prej 2422m2, me kulturë "kulosë" kl.5, P-71813026-03469-0, ne sipërfaqe prej 250 m2, me kulturë "shtëpi me oborr", P-71813026-03470-0, në sipërfaqe prej 205m, me kulturë "arë" kl.4, P-71813026-03471-0, në sipërfaqe prej 260m2, me kulturë "pemishte" kl.4, P-71813026-03472-0, në sipërfaqe prej 290m2, me kulturë "rrugë private", P-71813026-03473-0, ne sipërfaqe prej 1591m2, me kulture "kulosë" kl.3 dhe P-71813026-03474-0, në sipërfaqe prej 790m2, me kulture "vreshtë" kl.4, që të gjitha në Zonën Kadastrale Zhur.

Nga leximi i vendimit të MPMS i datës 17.06.2019 lidhur me njohjen e të drejtës me aftësi të përhershme për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se paditëses i është njohur e drejta për pension për personat me pa aftësi të përhershme dhe i paguhet shuma mujore prej 75.00€.

Nga leximi i njoftimit mbi pushimin e hetimeve PP.nr.1820-11/23 e datës 04.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se ndaj të pandehurit Q.Q. nga fsh. Zhur, Komuna e Prizreni Prokurori i shtetit i ka pushuar hetimet për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme neni 403 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës, pasi që ka kaluar afati relativ i parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

Në këtë drejtim Ligji Nr.2004/26 për Trashëgiminë i Kosovës, në nenin 9 përcakton se: **“Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.”**

Gjithashtu neni 11.1 përcakton se: **“Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.”** Par. 3 i këtij neni përcakton se **“Këta persona thirren në trashëgim sipas radhës së caktuar në këtë Ligj.”** ndërsa par. 4 përcakton se **“Trashëgimtarët e radhës më të afërt të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.”**

Neni 12.1 i po të njëjtit ligj përcakton se **“Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij.”** Ndërsa par. 2 i po këtij neni përcakton se **“Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.”** Gjithashtu neni 13.1 përcakton se **“Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me Ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim.”** Ndërsa par. 2 i po këtij neni përcakton se **“Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta.”**

Nenin 139 i të po këtij ligji përcakton të drejtën për ndarje ku në par. 1 përcaktohet se **“Ndarjen e trashëgimit mund ta kërkojë çdo trashëgimtar në çdo kohë, por jo në një kohë të papërshtatshme.”**, ndërsa par.2 të po këtij neni përcakton se **“Kjo e drejtë nuk parashkruhet.”**

Ligji nr.03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, më saktësisht kapitulli III, që ka të bëjë me fitimin dhe humbjen e të drejtës së pronësisë parasheh mënyrat dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të kaluar pronësia mbi një send të paluajtshëm nga një pronar tek tjetri. Në këtë drejtim neni 36 par. 1 i këtij ligji shprehimisht thotë **“Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.”** Ndërsa par. 2 i po këtij neni përcakton se: **“Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente.”**

Çështja kryesore në këtë lëndë është nëse paditëses i takon e drejta e pronësisë si bashkëpronare në pjesë ideale të paluajtshmërive kontestuese, e të cilat në regjistrin kadastral evidentohet në emër të paditurve në bazë të vendimit noterial të trashëgimisë. Kështu që për

gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësja dhe të paditurit janë trashëgimtarë të të ndjerit M.Q. pasi që nga certifikata e lindjes së paditëses gjykata vërtetoi faktin se paditësja është bija e të ndjerit M.Q. – trashëgimlënësit të ngastrave kadastrale kontestuese dhe se ky fakt nuk është kontestuar as nga këtu të paditurit. Për gjykatën mbetet kontestuese fakti se trashëgimtarët – këtu të paditurit a e kanë përjashtuar nga trashëgimia të paditurën me arsyetimin se të paditurit paditëses gjatë jetës ia kanë ndarë truallin dhe ia kanë ndërtuar shtëpinë në Prizren për banim dhe jetesë, kështu që e njëjta me atë e ka marrë pjesën e trashëgimisë që do ti takonte.

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë kontestimore, e posaçërisht nga aktit noterial LRP.nr.4595/2016 lidhur me trashëgiminë e M.A.Q. i datës 30.11.2016, gjykata ka vërtetuar se trashëgimtarët I.Q., Q.Q., S.Ç. (bijtë e të ndjerit) e L.Ç. dhe B.Q. (nipat e të ndjerit M.Q. – djemtë e A.Q.) janë shpallur trashëgimtarë të rendit të parë të pasurisë së trashëgimlënësit M.Q. në njësitë kadastrale dhe se e kanë përjashtuar nga trashëgimia, gjegjësisht e kanë bërë fshehjen e trashëgimtares – paditëses J.B.Q. e cila në bazë të neni 12.1 të ligjit Për Trashëgiminë i Kosovës, është trashëgimtare e radhës së parë dhe ka të drejtën e plotë në trashëgim të pasurisë së babait të saj në pjesë të barabartë me vëllezërit e saj. Nga ekspertiza e ekspertit D.B. e datës 16.01.2023, është vërtetuar fakti se të paditurit I.Q., Q.Q., S.Ç., (bijtë e të ndjerit) evidentohen si pronarë me nga 2/8 e pjesës së pronave të poshtëshënuara, kurse L.Ç. dhe B.Q. (nipat e të ndjerit M.Q. – djemtë e A.Q.) evidentohet si pronarë me nga 1/8 e pronave të poshtëshënuara: P-71813006-00654-0 ne sipërfaqe prej 520 m², me kulturë "arë" kl.1, ZK Vlashnjë, -71813006-00745-1 në sipërfaqe prej 4363 m², me kulture "arë" kl.1. Zona Kadastrale Vlashnjë, P-71813026-01168-0, në sipërfaqe prej 13084 m², me kulturë "kullose" kl.6 ZK Zhur, P-71813026-01169-0, në sipërfaqe prej 13104 m², me kulture "mal" kl.6 ZK Zhur, P-71813026-01170-0, në sipërfaqe prej 864 m², me kulture "Mal" kl.6, ZK Zhur, P-71813026-01171-0, në sipërfaqe prej 15542 m², me kulture "arë" kl.7, ZK Zhur, P-71813026-01172-0, në sipërfaqe prej 26109 m², me kulture "kullosë" kl.6, P-71813026-01173-0, në sipërfaqe prej 12885m², me kulturë", P-71813026-01174-0, në sipërfaqe prej 2672 m², me kulturë "livadh" kl.7, P-71813026-01175-0, në sipërfaqe prej 1249 m², me kulturë "mal" kl.5, P-71813026-01176-0, në sipërfaqe prej 2422m², me kulturë "kullosë" kl.5, P-71813026-03469-0, ne sipërfaqe prej 250 m², me kulturë "shtëpi me oborr", P-71813026-03470-0, në sipërfaqe prej 205m, me kulturë "arë" kl.4, P-71813026-03471-0, në sipërfaqe prei 260m², me kulturë "pemishte" kl.4, P-71813026-03472-0, në sipërfaqe prei 290m², me kulturë "rrugë private", P-71813026-03473-0, ne sipërfaqe prej 1591m², me kulture "kullosë" kl.3 dhe P-71813026-03474-0, në sipërfaqe prej 790m², me kulture "vreshtë" kl.4, që të gjitha në Zonën Kadastrale Zhur.

Gjykata e ka vlerësuar dhe aktvdekjen për të ndjerin M.A.Q. nr.200-811 e datës 24.11.2016, ku si trashëgimtarë të ndjerit janë paraqitur këtu të paditurit dhe të njëjtës nuk ia fal besimin, kjo për faktin se nga provat e administruara më lartë konkretisht nga ekstrakti nga regjistri qëndron i gjendjes civile nr, E 23329428 i datës 24.03.2019 lëshuar për paditësen vërtetohet fakti se e njëjta është e bija e të ndjerit dhe i plotëson të gjitha kushtet ligjore që të jetë trashëgimtare e të ndjerit.

Meqenëse paditësja është e bija e të ndjerit, fakt ky i cili nuk është kontestues as për palët e paditura, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 11.1 se **“Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.”** Par. 3 i këtij neni ka përcaktuar se **“Këta persona thirren në trashëgim sipas radhës së caktuar në këtë Ligj”**, ndërsa par.4 përcakton se

“Trashëgimtarët e radhës më të afërt të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.”, andaj paditësit padrejtësisht e kanë përjashtuar paditësen nga trashëgimia, duke ia mohuar një të drejtë primare të cilën ia ka garantuar ligji, të trashëgojë babain e saj, andaj e njëjta e fiton pronësinë mbi bazën e trashëgimisë më hollësisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve dhe deklarimeve të paditurve se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e pa bazuar ngase paditëses të paditurit gjatë jetës ia kanë ndarë truallin dhe ia kanë ndërtuar shtëpinë në Prizren për banim dhe jetesë, kështu që në këtë mënyrë është përmbushur në tërësi kërkesëpadia e parashtruar me padi, gjykata i vlerësoi si të pa bazuara, pasi që në nenin 7.1 të LPK-së përcakton se **“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”** dhe palët e paditura në këtë drejtim me asnjë provë të vetme nuk e kanë vërtetuar para gjykatës se paditësja është përmbushur në ndonjë mënyrë tjetër apo të ketë dhënë ndonjë deklaratë se heqë dorë nga trashëgimia në dobi të trashëgimtarëve tjerë – këtu të paditurve, e ndër të tjera me asnjë provë nuk është vërtetuar se paditësja të jetë përjashtuar nga trashëgimia për ndonjë shkak të paraparë sipas dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit për Trashëgiminë (neni 114, 115, 116, 117 dhe 118) apo për shkak të padenjesisë apo ndonjë shkak tjetër i cili e bënë paditësen të padenjë për të trashëguar (neni 110, 11., 112 dhe 113).

Duke marrë parasysh se objekt i këtij kontesti janë njësitë kadastrale të përshkruara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia njohur të drejtën e pronësisë paditëses në pjesë ideale prej 1/5 në të gjitha ngastrat kadastrale kontestuese për shkak se paditësja në njërin anë është njëra nga trashëgimtarët ligjor, ndërsa në anën tjetër edhe po ti takonte ndonjë pjesë ideale më e madhe këtë gjykata nuk mund ta pranojë sepse në rastin konkret do të kishim tejkalim të kërkesë padisë.

Përfundimisht në bazë të lartcekurave, gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, respektivisht se ka kushte ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë, në pjesët të cilat janë cekur në dispozitiv, andaj kërkesëpadia e paditëses u aprovua në tërësi si e bazuar.

Gjykata ka vendosur që **masa e sigurimit** e caktuar nga ana e kësaj gjykate, me aktvendimin C nr. 907/2019, datë 16.09.2021, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi ose deri në marrjen e vendimit tjetër nga ana e kësaj gjykate, në mënyrë që të mos vije deri tek shkaktimi i ndonjë dëmi të pariparueshëm për palët ndërgjyqëse, konform dispozitave ligjore të nenit 309.2 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve të palëve të paditura lidhur me parashkrimin e të drejtës së palës paditëse për të kërkuar pasurinë trashëgimore, gjykata të njëjtën e vlerësoi si të pa bazuar, pasi që paditësja është trashëgimtare e rendit të parë dhe ka të drejtë të plotë të kërkonë trashëgiminë e trashëgimlënësit – babin të saj të vdekur, e bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Trashëgimisë i Kosovës dhe se në anën tjetër duke marr për bazë se aktvendimi noterial nr.4595/2026 është i datës 30.11.2016 dhe gjykata vlerëson se kërkesa është parashtruar brenda afateve ligjore.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:131070
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737188

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 449 dhe 452 par.1 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së lidhur me Tarifën e OAK-së, ashtu që i detyroi të paditurit që paditëses solidarisht t'ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë për përfaqësim në 3 seanca të mbajtura e në shumë prej 135.00€, e në shumë të përgjithshme prej 405.00€.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetimit të këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil-
C.nr.907/19 më datë 18.04.2024

Gjyqtari
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.